



## Heshtja për Enver Hoxhën po thyhet!

Pikërisht me rastin e 100 vjetorit të lindjes së të madhit Enver Hoxha, heshtja e hekurt institucionale e klikës së Sali Berishës dhe asaj të Fatos Nanos, filloi të thyhet. Çarjen e parë e bënë shqiptarët e Kosovës, të cilët duke përbuzur çjerrjet gurmazore të Sali Berishës për të hequr dorë nga manifestimet e paralajmëruara dhe pjesëmarrja në to, pa u trmbur as nga pushtetmbajtësit e sotëm në Kosovë, përkujtuan me dinjitet 100 vjetorin e lindjes së Enver Hoxhës, me ç'rast promovuan meritat e pamohueshme të Enver Hoxhës dhe epokën e Tij 50 vjeçare të socializmit.

Redaksia e faqes së internetit kushtuar figurës së Enver Hoxhës, jetës dhe veprës së Tij të pavdekshme, organizimet në Prishtinë, Tiranë, Gjirokastrë dhe vise tjera shqiptare me rastin e ditëlindjes së Enver Hoxhës, i sheh si fillim i mbarë i diskutimit dhe publikimit të historisë 50 vjeçare të historisë më të re, histori të cilën pushtetmbajtësit në Tiranë dhe Prishtinë më kot përpiqen ta mbajnë të fshehur nën dryrin e hekurt, kot përpiqen ta shtrembërojnë. E vërteta nuk shtrembërohet as me dhunë, as me kërbaç e as me diktat. Historia dhe faktet historike nuk fshihen as nuk shlyhen dot. E vërteta gjithmonë ka triumfuar dhe do të triumfojë edhe kësaj radhe, duke i kthyer vendin e merituar Enver Hoxhës.

Në Tiranë këtë vit u botua edhe një libër kushtuar jetës dhe veprës së Enver Hoxhës, libër i cili botohet me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Enver Hoxhës.

Por, fjalën po ua lëmë të tjerëve të flasin për të, duke filluar nga manifestimi në Sallën e Kuqe në Prishtinë.

Shpati